

-III- Nr. i prot. 3017 Më 09.11.2018
Br. prot. RAHOVEC - ORAHOVAC Dt.



KOMUNA E RAHOVECIT
OPSTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY OF RAHOVEC

KONTRATA

Emri i Autoritetit Kontraktues: **Komuna e Rahovecit me adresë në rrugën "Xhelal Hajda – Toni" të cilën e përfaqëson Menaxheri i Prokurimit: Jetulla Kabashi, dhe**

Emri i Kontraktuesit: **"EAE – NJAZ" Sh.p.k. me adresë në Rahovec, të cilën e përfaqëson Emrim Selmancena**

janë pajtuar te lidhin një kontrate publike për:

TITULLI I KONTRATËS: INVESTIMET NË ZONËN EKONOMIKE NË OPTERUSHË

Numri i Prokurimit: **623-18-7712-5-3-6**

Numri i Brendshëm: **623-18-066-5-3-6**

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kontratës do të jetë: **Investimet në zonën ekonomike në Opterushë – Sipas Specifikacionit dhe Ofertës.**

1.2 Kontrata hynë në fuqi me: **09.11.2018** dhe përfundon me: **Sipas dinamikës së punëve, brenda Kontratës: 3 muaj, dhe përfundon me dorëzimin e Situacionit përfundimtarë.**

1.3 Afati kohor i performances nuk mund të jetë më shumë se *[shëno numrin]* ditë nga data e marrjes së urdhëreses.

1.4 Vendi i ekzekutimit të punëve do të jetë: **Në fshatin Opterushë.**

1.5 Incotermi i aplikueshëm do të jetë DDP¹ (Detyra e Dërguar e Paguar).

¹ DDP – Detyra e Dërguar e Paguar- Incoterms 2010 Oda Ekonomike Ndërkombëtare

Neni 2 Ligji i aplikueshëm

2.1 Ligji i zbatueshëm do të jetë sipas Nenit 40 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092 Për çështjet që nuk mbulohen me dispozita të kontratës, zbatohen ligjet në fuqi në Kosovë. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.

Neni 3 Çmimi

3.1 Cmimi total i kontratës do të jetë: **4,360.00 €**,

[Katërmijë e treqind e gjashtëdhjetë Euro e zero zero Cent] Euro.

3.2 Çmimi i përmendur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vëmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Operatorit Ekonomik sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtronet ndryshimeve gjatë ekzekutimit të kontratës (në përashtim të çmimeve të atyre artikujve që i nënshtronen ndryshimit të çmimit sipas berzës përkatëse, nëse aplikohet).

Neni 4 Pagesat

4.1 Pagesa do të bëhet në Euro.

Pagesat kontraktuesit do t'i bëhet në bazë të raportit të organit mbikqyrës.

4.2 Pagesat e detyrimeve sipas një fature të lëshuar nga Operatori Ekonomik duhet të paguhet brenda jo më shumë se 30 ditësh nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkuesat thelbësore.

Neni 5 Marrëveshjet lidhur me tatimin dhe doganën

5.1 Operatori Ekonomik është përgjegjës për të gjitha detyrimet dhe taksat në përputhje me Ligjin e Republikës së Kosovës.

5.2 Të gjitha taksat dhe detyrat e tjera doganore konsiderohen se janë të përfshira në çmimin e kontratës.

Neni 6 Kualiteti

6.1 Kualiteti i punëve duhet në të gjitha aspektet të plotësoj specifikimet teknike të parashtruara në Dosjen e Tenderit.

Neni 7 Garancioni

7.1 Shuma e Sigurisë së Ekzekutimit është: **10 % e vlerës së kontratës, për kohëzgjatjen e periudhës prej: [3 muaj + 30 ditë].**

Neni 8 Vonesat në ekzekutim

8.1 Nëse Operatori Ekonomik me përgjegjësinë e tij nuk arrin [te kryej ndonjë ose te gjitha punët] brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me 0,25% në ditë të vlerës së [punëve] të pa dorëzuara deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të kontratës.

Neni 9 Inspektimi dhe testimi

9.1 Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë që herë pas here të inspektojë, kontrollojë, masë dhe testojë komponentët, materialet, dhe mjeshtërinë, dhe të kontrollojë përparimin e përgatitjes, fabrikimit apo prodhimit të çfarëdo artikulli që përgatitet, fabrikohet ose prodhohet për t'u dorëzuar sipas kontratës, në mënyrë që të përcaktojë nëse komponentët, materialet dhe mjeshtëria kanë cilësinë dhe sasinë e kërkuar.

Neni 10 Nën-kontraktimi

10.1 Një nënkonratë do të jetë e vlefshme vetëm nëse është një marrëveshje me shkrim me të cilin Operatori Ekonomik i beson kryerjen e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë. Operatori Ekonomik nuk duhet të nënkontrakojë pa autorizim paraprak me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Autoriteti Kontraktues do të njoftojë Operatorin Ekonomik për vendimin e tij brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi.

Neni 11 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti kontraktues

11.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Operatorit Ekonomik shtatë ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet në vijim: a) Kur operatori ekonomik nuk arrin t'i realizoj obligimet e veta sipas kontratës; b) Dështon në ekzekutimin e kontratës në afatin e caktuar; c). Refuzon urdhrat administrativ të autoritetit kontraktues; d) Ia jep dikujt kontratën apo nënkonratën pa autorizim nga autoriteti kontraktues; e). Falimenton; f). Është dënuar nga një gjykatë për një shkelje që ka të bëjë me sjellje profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res-judikata*; g) Operatori ekonomik i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale ose ndonjë aktivitet tjetër ilegal që i dëmton interesat e përgjithshme financiare; h) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës.

Neni 12 Ndërprerja e Kontratës nga Operatori Ekonomik

12.1 Operatori Ekonomik, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin Kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues: a) Nuk arrin t'i paguajë Operatorin Ekonomik shumën që duhet të paguhet brenda periudhës së saktësuar me kontratë; b) vazhdimesh nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta me kontratë; c) si rezultat i forcës madhore, Operatori Ekonomik nuk është në gjendje për të kryer një pjesë materiale të kontratës për më shumë se 180 ditë, për arsyet që nuk janë specifikuar në kontratë ose që nuk i atribuohen të Operatorit Ekonomik.

Neni 13 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

13.1 Nëse nuk mund të arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje të mosmarrëveshjes, secila pale mund të kërkojë ose vendim nga gjyqi, ose vendim arbitrimi.

13.2 Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në [Gjykata Themelore Gjakovë – Dega Rahovec] në pajtim me ligjin e Kosovës.



Neni 14 Komunikimi

14.1 Çdo komunikim me shkrim në lidhje me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues dhe Operatorit Ekonomik duhet jap Titullin e kontratës dhe numrin ei identifikimit, dhe duhet të dërgohet me postë, faks, e-mail ose me dorë.

E hartuar në gjuhen [Shqip] në tri originale, dy originale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Operatorin Ekonomik.

Për Operatorin Ekonomik

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Emrim Selmancena	Emri:	Jetulla Kabashi
Pozita:	Drejtore	Pozita:	Menaxher i prokurimit
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	09.11.2018	Data:	09.11.2018
Vula:		Vula:	


PARAMASA DHE PARALLOGARIA

Rrafshimi dhe nivelizimi I nje pjese te zones ekonomike ne fshatin Apterush

I	PUNET E DHEUT	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
Nr.	Përshkrimi i Posicionit				
1	Mobilizimi I ndermarjes si dhe transportimi i makineris deri ne punishte	Copë	1	100	100
2	Germimi i dheut te kategoris se III dhe IV ne thellesi mesatare h=60cm' mvarisht prej tereni si dhe rrafshim ne pjeset tjera ku eshte tereni me i ulet apo ku ka lugje.	m2	7200	0,55	3960
3	Ngarkim , transportimi I gureve masiv dhe betonave te cilat jan hudhur nga qytetare me parë deri ne deponin legale per grombullimin e mbeturinave te ngurta.	m3	60	5	300
Totali :					4360

REKAPITULIMI

I	PUNET E DHEUT	4,360	€
	TOTALI ME TVSHË	4,360	€



[Handwritten signature]